



International Criminal Tribunal  
for the former Yugoslavia  
Tribunal Pénal International  
pour l'ex-Yugoslavie

# (IT-95-5/18) RADOVAN KARAXHIQ



*Akuzuar për gjenocid, shfarosje, vrasje, përndjekje, dëbim, veprime çnjerëzore, veprime dhune synimi parësor i të cilave ishte terrorizimi i popullatës civile, sulme të paligjshme kundër civilëve, pengmarrje*

**RADOVAN  
KARAXHIQ**



Anëtar themelues dhe Kryetar i Partisë Demokratike Serbe (SDS) deri më 19 korrik 1996; më 27 mars 1992 u bë Kryetar i Këshillit të Sigurimit Kombëtar të së ashtuquajturës Republika Serbe e Bosnjës dhe Hercegovinës (më vonë Republika Srpska "RS"); më 12 maj 1992 u bë Kryetar i Kryesisë trianëtarëshe të RS-së dhe shërbeu në Kryesi deri më 17 dhjetor 1992; prej 30 nëntorit 1992 ose rreth kësaj date anëtar i Komandës së Lartë të forcave të armatosura të RS-së; Kryetar i vetëm i Republika Srpska dhe Kryekomandant i vetëm i forcave të saj të armatosura prej 17 dhjetorit 1992

*Krimet për të cilat akuzohet (shembuj):*

**Gjenocid:**

- Në bashkëpunim me të tjerë ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe/ose ndihmoi dhe inkurajoi gjenocidin kundër një pjese të kombësisë ose etnisë dhe/ose përkatësisë fetare muslimane bosnjake dhe/ose kroate bosnjake. Ai mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK) për largimin përfundimtar të muslimanëve bosnjakë dhe kroatëve bosnjakë prej territoreve të Bosnjës dhe Hercegovinës (BiH) të pretenduara si territore të serbëve bosnjakë;
- Ai mori pjesë në NPK për likuidimin e muslimanëve bosnjakë në Srebrenicë nëpërmjet vrasjes së burrave dhe djemve të Srebrenicës dhe largimit të dhunshëm të grave, fëmijëve të vegjël dhe disa pleqve nga Srebrenica.

**Përndjekje, shfarosje, vrasje, dëbim, veprime çnjerëzore (krime kundër njerëzimit):**

- Në bashkëpunim me të tjerë ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe/ose ndihmoi dhe inkurajoi përndjekje mbi baza politike dhe/ose fetare kundër muslimanëve bosnjakë dhe/ose kroatëve bosnjakë në këto komuna: Banjalukë/Banja Luka, Bijelinë/Bijeljina, Bosanska Krupa, Bosanski Novi, Bosanski Petrovac, Bratunac, Bërçko/Brčko, Čajniçë/Čajniče, Vakuf i Poshtëm/Donji Vakuf, Foça/Foča, Haxhiqi/Hadžići, Ilixha/Ilidža, Ilijash/Ilijaš, Kalinovik, Kluç/Ključ, Kotor Varosh/Kotor Varoš, Novi Grad, Novo Sarajevo, Pale, Prijedor, Rogatica, Sanski Most, Sokolac, Vishegrad/Višegrad, Vllasenicë/Vlasenica, Vogoshqa/Vogošća dhe Zvornik si dhe përndjekjet e muslimanëve bosnjakë të Srebrenicës ("Komunat");
- Ai është përgjegjës për shfarosjen dhe vrasjet që ishin pjesë e synimit të largimit përfundimtar të muslimanëve bosnjakë dhe kroatëve bosnjakë prej territorit të pretenduar nga serbët bosnjakë që u kryen gjatë periudhës mars 1992 - 30 nëntor 1995 prej anëtarëve të forcave serbe dhe organeve politike serbe bosnjake ndër të cilat vrasjet gjatë marrjes nën kontroll të komunave dhe më pas dhe vrasjet në kampet e burgimit në Komunat;

*Vrasje, veprime dhune synimi parësor i të cilave ishte terrorizimi i popullatës civile, sulme të paligjshme kundër civilëve, pengmarrje (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës):*

- Midis prillit 1992 dhe nëntorit 1995, Radovan Karaxhiqi në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të NPK-së krijoi dhe zbatoi një strategji ushtarake me përdorimin e qitjeve të snajperëve dhe granatimin për vrasjen, gjymtimin, plagosjen dhe terrorizimin e banorëve civilë të Sarajevës që rezultoi në vrasjen dhe plagosjen e mijëra civilëve të të dy gjinive dhe të të gjitha moshave, duke përfshirë edhe fëmijët dhe të moshuarit.
- Afërsisht midis 26 majit 1998 dhe 19 qershorit 1995, forcat serbe bosnjake ndaluan më shumë se 200 paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara dhe vëzhgues ushtarakë dhe i mbajtën në vende të ndryshme ndër të cilat Pale, Sarajevë, Banjallukë dhe Gorazhde /Goražde dhe i mbajtën në vende të ndryshme në Republika Srpska. Të tretët ndër të cilët komandantë të NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara, u kërcënuan se sulme të tjera të NATO-s kundër objektivave ushtarakë të serbëve bosnjakë do të shkaktonin lëndimin, vdekjen ose vazhdimin e burgimit të të ndaluarve. Disa prej të ndaluarve u sulmuan ose u keqtrajtuuan gjatë mbajtjes së tyre.

<b>Lindur</b>	19 qershor 1945, në komunën e Shavnikut/Šavnik, Mal i Zi
<b>Aktakuza</b>	Aktakuza fillestare: 25 korrik 1995; e veçuar (Srebrenica): 16 nëntor 1995; e ndryshuar: 31 maj 2000; e ndryshuar për herë të dytë: 16 shkurt 2009; e ndryshuar për herë të tretë: 26 shkurt 2009
<b>Arrestuar</b>	21 korrik 2008 (njoftim prej autoriteteve serbe)
<b>Transferuar në TPNJ</b>	30 korrik 2008
<b>Paraqitja e Parë dhe të Tjerat</b>	31 korrik 2008, e shtyu deklarinimin për 30 ditë; 29 gusht 2008, nuk u deklarua, për të u bë vetëdeklarimi i pafajësisë; 3 mars 2009

## TË DHËNA

FAZA PARAGJYQËSORE	
Dhoma Gjyqësore III	Kryegjykatës O-Gon Kwon, Gjykatës Howard Morrison, Gjykatës Melville Baird dhe Gjykatës Flavia Lattanzi (Gjykatës rezervë)
Përfaqësues të Prokurorisë	Alan Tieger, Mark Harmon, Hildegard Uertz-Retzlaff
Avokat i Mbrojtjes	Vetëpërfaqësim

ÇËSHTJE QË KANË LIDHJE <i>prej zonës gjeografike</i>
BANOVIĆ (IT-02-65/1) "OMARSKA CAMP & KERATERM CAMP"
BEARA (IT-02-58) "SREBRENICA"
BLAGOJEVIĆ AND JOKIĆ (IT-02-60) "SREBRENICA"
BOROVČANIN (IT-02-64)
BOROVNICA (IT-95-3) "PRIJEDOR"
BRĐANIN (IT-99-36) "KRAJINA"
ERDEMOVIĆ (IT-96-22) "PILICA FARM"
GALIĆ (IT-98-29) "SARAJEVO"
KRAJIŠNIK (IT-00-39 & 40) "BOSNIA AND HERZEGOVINA"
KRNOJELAC (IT-97-25) "FOČA"
KRSTIĆ (IT-98-33) "SREBRENICA-DRINA CORPS"
KUNARAC, KOVAČ & VUKOVIĆ (IT-96-23 & 23/1) "FOČA"
KVOČKA <i>et al.</i> (IT-98-30/1) "OMARSKA CAMP & KERATERM CAMP"
MEJAKIĆ <i>et al.</i> (IT-02-65) "OMARSKA CAMP & KERATERM CAMP"
MLADIĆ (IT-95-5/18)
MRĐA (IT-02-59) "VLASIC MOUNTAIN"
MILOŠEVIĆ (IT-02-54) "KOSOVO, CROATIA & BOSNIA "
NIKOLIĆ, DRAGO (IT-02-63) "SREBRENICA"
PLAVŠIĆ (IT-00-39 & 40/1) "BOSNIA AND HERZEGOVINA"
OBRENOVIĆ (IT-02-60/2) "SREBRENICA"
PANDUREVIĆ & TRBIĆ (IT-05-86) "SREBRENICA-DRINA CORPS"
PERIŠIĆ (IT-04-81)
POPOVIĆ <i>et al.</i> (IT-02-57) "SREBRENICA"
SIKIRICA <i>et al.</i> (IT-95-8) "KERATERM CAMP"
STANIŠIĆ (IT-04-79)
STAKIĆ (IT-97-24) "PRIJEDOR"
TADIĆ (IT-94-1) "PRIJEDOR"
TOLIMIR (IT-05-88/2)

## AKTAKUZA DHE AKUZAT

Aktakuza e parë kundër Radovan Karaxhiqit dhe Ratko Mlladiqit (lënda numër IT-95-5) u dorëzua më 24 korrik 1995, u konfirmua më 25 korrik 1995 ku ata u akuzuan për gjenocid dhe kryerjen e krimeve të tjera kundër civilëve anembanë territorit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Më 14 nëntor 1995 Prokurori dorëzoi një aktakuzë të përbashkët të veçantë kundër po këtyre dy të akuzuarve (lënda numër IT-95-18) e cila u konfirmua më 16 nëntor 1995 dhe trajtonte vetëm ngjarjet në Srebrenicë në korrik 1995.

Dy aktakuzat fillestare të përfshira në një dokument të vetëm krijuan aktakuzën e ndryshuar kundër Radovan Karaxhiqit (lënda numër IT-95-5/18) e cila u dorëzua më 24 maj 2000.

Më 22 shtator 2008, Prokuroria dorëzoi një mocion për ndryshimin e aktakuzës ku ndër të tjera kërkonte heqjen e akuzës së bashkëfajësisë në gjenocid dhe ndarjen e pikës së gjenocidit në dy pika, ku secila përfaqësonte një periudhë të ndryshme kohore dhe vendndodhje tjetër. Për më tepër Prokuroria pakësoi nga 41 në 27 numrin e gjithsejtë të komunave ku pretendohet se i akuzuari kreu krimet. Më 16 shkurt 2009, Dhoma Gjyqësore miratoi mocionin e Prokurorisë me përjashtim të tri incidenteve të vrasjeve që Prokuroria kërkoi të shtonte me arsyetimin se “nuk konfirmoheshim prej provave”. Më 17 shkurt 2009, Prokuroria dorëzoi një mocion të ngutshëm ku kërkonte që Dhoma të rishikonte vendimin e vet në lidhje me një incident vrasjeje në kampin Sushica. Më 26 shkurt 2009, Dhoma Gjyqësore rishikoi vendimin e vet të mëparshëm dhe urdhëroi Prokurorinë të paraqiste një aktakuzë të re të ndryshuar ku të përfshinte incidentin e pretenduar në kampin Sushica. Aktakuza e ndryshuar për herë të tretë (“aktakuza”) u dorëzua më 27 shkurt 2009.

Në aktakuzë pretendohet se të paktën prej tetorit 1991 deri më 30 nëntor 1995, Radovan Karaxhiqi mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale gjithëpërfshirëse (“NPK”) për largimin përfundimtar të banorëve muslimanë bosnjakë dhe kroatë bosnjakë nga territore të Bosnjës dhe Hercegovinës të pretenduara si territore të serbëve bosnjakë ndër të tjera nëpërmjet kryerjes së krimeve të përmendura në aktakuzë. Pretendohet se për kryerjen e secilit prej këtyre krimeve ai kishte synim të përbashkët me anëtarë të tjerë të NPK-së ndër të cilët Momçillo Krajishnik, Ratko Mlladiq, Slobodan Millosheviq, Bilana Pllavshiq, Nikolla Koleviq, Miqo Stanishiq, Momçillo Mandiq, Jovica Stanishiq, Franko Simatoviq, Zhelko Razhnatoviq me pseudonimin “Arkan” dhe Vojisllav Sheshel.

Gjithashtu pretendohet se gjatë periudhës prill 1992 - nëntor 1995, Radovan Karaxhiqi mori pjesë në një NPK anëtarë të së cilës ndër të tjerë ishin Momçillo Krajishnik, Ratko Mlladiq, Bilana Pllavshiq, Nikolla Koleviq, Miqo Stanishiq, Stanisllav Galiq, Dragomir Millosheviq dhe Vojisllav Sheshel për nisjen dhe kryerjen e fushtatës së qitjes me snajper dhe granatimit kundër popullatës civile të Sarajevës, qëllimi parësor i së cilës ishte terrorizimi i popullatës civile. Synimi përfshinte kryerjen e krimeve të terrorit, sulme të paligjshme kundër civilëve dhe vrasje të akuzuara në aktakuzë.

Më tej në aktakuzë pohohet se duke filluar në ditët pikërisht para zbatimit të planit të 11 korrikut 1995 për likuidimin e muslimanëve bosnjakë në Srebrenicë që vazhdoi deri më 1 nëntor 1995, Radovan Karaxhiqi mori pjesë në një NPK për likuidimin e muslimanëve bosnjakë në Srebrenicë nëpërmjet vrasjes së burrave dhe djemve të Srebrenicës dhe largimit të dhunshëm të grave, fëmijëve të vegjël dhe disa pleqve nga Srebrenica. Ndër anëtarë të tjerë të NPK-së ishin: anëtarë të organeve politike dhe qeveritare republikane të serbëve bosnjakë; anëtarë të organeve politike dhe qeveritare krahinore, komunale dhe lokale me përgjegjësi për ose në zonat e Srebrenicës, Vllasenicës, Bratunacit dhe/ose Zvornikut; komandantë; ndihmëskomandantë, oficerë të lartë dhe shefa të Ushtrisë së Republika Srpska (VRS) dhe policisë (MPB) që vepronin ose që ishin përgjegjës për territorin e zonës së përgjegjësisë së Korpusit të Drinës të VRS-së dhe/ose komunës së Tërnovës; dhe anëtarë të një njësi të MPB-së serbe i quajtur “Akrepas”. Ndryshe disa ose të gjithë këta

individë nuk ishin anëtarë të NPK-së por u shfrytëzuan prej anëtarëve të NPK-së në kryerjen e krimeve për realizimin e synimit.

Bazuar në përgjegjësinë individuale penale (Neni 7(1)) dhe përgjegjësinë penale si epror (Neni 7(3)), **Radovan Karaxhiqi** akuzohet për:

- **Gjenocid, përndjekje, shfarosje, vrasje, dëbim, veprime çnjerëzore** (gjenocid, krim kundër njerëzimit, Nenet 4 dhe 5),
- **Vrasje, sulme të paligjshme kundër civilëve, veprime dhune synimi parësor i të cilave është terrorizimi i popullatës civile, pengmarrje** (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

## PROCEDURA E RREGULLËS 61

Në disa raste kur Tribunali nuk ka mundur të paraburgosë një të akuzuar, është vepruar sipas Rregullës 61 të Rregullores së Procedurës dhe Provave. Sipas kësaj rregulle, Dhoma Gjyqësore në përbërje të plotë shqyrton aktakuzën dhe provat përkatëse publikisht dhe nëqoftëse konkludon se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të besuar se i akuzuari kreu çfarëdo prej krimeve të akuzuara ose të gjitha krimet, konfirmon aktakuzën dhe lëshon një fletarrestim ndërkombëtar nëpërmjet të cilit synohet të mundësohet arrestimi i të akuzuarit në rast se ai kalon përmes kufijve shtetërorë. Gjithashtu bazuar në vërtetimin prej Prokurorisë Dhoma mund të sanksionojë se mosdorëzimi i fletarrestimit të akuzuarit ishte për shkak të moszbatimit të fletarrestimit apo refuzimit të një shteti për të bashkëpunuar me Tribunalin. Në këtë rast Kryetari i Tribunalit në këshillim me Kryegjykatësit e Dhomave Gjyqësore, mund të informojë Këshillin e Sigurimit për mosveprimin ose refuzimin. Seanca e Rregullës 61 nuk është gjykim në mungesë dhe nuk jep verdikt fajësie.

Pas konfirmimit të aktakuzave kundër Radovan Karaxhiqit dhe Ratko Mlladiqit më 24 korrik 1995 dhe më 16 nëntor 1995, fletarrestimet iu përcollën Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal I Zi), Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe administratës serbe bosnjake (Republika Srpska). Më 18 qershor 1996, duke marrë parasysh se fletarrestimet nuk ishin zbatuar dhe se Prokurori kishte ndërmarrë hapa të arsyeshme për të informuar të akuzuarit mbi ekzistencën e tyre, Gjykatësi Claude Jorda urdhëroi që të dy aktakuzat t'i paraqiteshin për shqyrtim Dhomës Gjyqësore bazuar në Rregullën 61 të Rregullores së Procedurës dhe Provave.

Më 11 korrik 1996, Dhoma Gjyqësore konfirmoi të tëra pikat e aktakuzës, pasi ishte bindur se Prokurori kishte paraqitur prova që ofronin arsye të mjaftueshme për të besuar se Radovan Karaxhiqi dhe Ratko Mlladiqi kishin kryer krimet e pretenduara dhe lëshoi një fletarrestim ndërkombëtar duke urdhëruar që t'u dërgohej të tëra shteteve dhe Forcës Shumëkombëshe Ushtarake udhëhequr prej NATO-s (IFOR) që në atë kohë vepronte në BiH.

Gjithashtu Dhoma Gjyqësore gjykoi se mosarrestimi i Radovan Karaxhiqit dhe Ratko Mlladiqit mund t'i atribuohet refuzimit për bashkëpunim me TPNJ-në prej Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal I Zi) dhe Republika Srpska. Dhoma Gjyqësore theksoi veçanërisht se ky mosveprim ishte shkelje e detyrimeve të marra në emër të Republika Srpska prej RFJ-së gjatë marrëveshjeve të Dejtonit për paqe. Aty deklarohet se si garantues i Republika Srpska, RFJ-ja është përgjegjëse për mospërmblidhjen e detyrimeve prej këtij entiteti. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore i kërkoi Kryetarit të Tribunalit t'ia raportonte mosrespektimin e detyrimeve ligjore Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe më 11 korrik 1996, Kryetari Antonio Cassese dërgoi letrën përkatëse. Pas kësaj letrë Këshilli i Sigurimit lëshoi disa rezoluta ku inkurajohej respektimi i udhëzimeve të Tribunalit dhe deklarohet se Këshilli i Sigurimit do të ishte aktivisht i angazhuar me çështjen.

